



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

RELACION

MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027–2029”, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2027–2029.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 7 datë 27.02.2026 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2027-2029”, përmban:

- a) Shtojca 1 : Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2027-2029;
- b) Shtojca 2 : Struktura e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029
- c) Shtojca 3 : Treguesit kryesorë të kuadrit makroekonomik e fiskalë 2027-2029
- d) Shtojca 4 : Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve
- e) Shtojca 5 : Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit 2025 për Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë
- f) Shtojca 6 dhe 7 : Detyrat e Sugjeruara dhe Afatet e Brendshme për Miratimin e Projekt Dokumentit të PBA (Faza 1)

Bashkia Berat është pjesë e njësive të vetëqeverisjes vendore që zbatojnë metodologjinë e re të përgatitjes së PBA-së, sipas Shtojcës nr. 5 të udhëzimit të sipërcituar.

Kjo metodologji është zbatuar nga Bashkia Berat prej dy vitesh dhe konsiston në:

- Strukturimin e buxhetit sipas programeve të lidhura me ofrimin e shërbimeve;
- Planifikimin dhe zbatimin e buxhetit në nivel produkti;
- Përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV);
- Ruajtjen e raportimit funksional sipas klasifikimit COFOG përmes produkteve.

Zbatimi i kësaj metodologjie ka sjellë:

- Konsolidim të programeve buxhetore;
- Rritje të fleksibilitetit në menaxhimin e burimeve;
- Përmirësim të planifikimit dhe monitorimit të shpenzimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

I. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, në nivel programi buxhetor.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2027-2029 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 9 datë 15.01.2026, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029. Kuadri makroekonomik e fiskal pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Një “tavan” në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2027-2029 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor në fuqi.
- Transferta e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2027-2029, së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, financojnë funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2025.

Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

I.1 Parashikimi i të ardhurave

Parashikimet janë bazuar në:

- Ecurinë historike të realizimit të të ardhurave;
- Politikat fiskale vendore në fuqi dhe pritshmëritë për përmirësim të administrimit fiskal;
- Parashikimet për transfertat nga buxheti i shtetit;
- Mundësitë për sigurimin e financimeve të huaja;
- Stabilitetin makroekonomik dhe pritshmëritë për rritje graduale ekonomike.

1. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, si dhe transfertës për rritjen e nivelit të pagave për periudhën 2027–2029, është përcaktuar sipas Shtojcës nr. 1 të Udhëzimit nr. 7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përcaktimi i kësaj transferte bazohet në formulën ligjore të shpërndarjes, sipas nenit 24 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo formulë merr në konsideratë disa tregues objektivë, konkretisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

- Popullsinë (bazuar në harmonizimin e të dhënave të gjendjes civile me censusin);
- Dendësinë e popullsisë për km²;
- Numrin faktik të nxënësve në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm.

Këta indikatorë synojnë një shpërndarje sa më të drejtë dhe të balancuar të burimeve financiare ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për Bashkinë Berat, transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme paraqitet si më poshtë:

- **Viti 2027:** 559,632 mijë lekë
(+39,112 mijë lekë ose +7.5% krahasuar me vitin 2026)
- **Viti 2028:** 594,494 mijë lekë
(+34,862 mijë lekë ose +6.2% krahasuar me vitin 2027)
- **Viti 2029:** 625,546 mijë lekë
(+31,052 mijë lekë ose +5.2% krahasuar me vitin 2028)

Kjo rritje progresive reflekton:

- Politikat mbështetëse të qeverisë qendrore ndaj pushtetit vendor;
- Rritjen e kapaciteteve financiare për përballimin e shërbimeve publike;
- Nevojën për mbështetje të funksioneve bazë të bashkisë.

1.1 Transferta për rritjen e nivelit të pagave

Për të gjithë periudhën 2027–2029 është parashikuar një transfertë e veçantë për financimin e rritjes së nivelit të pagave në shumën: **90,995 mijë lekë në vit**

Ky zë mbetet i pandryshuar krahasuar me vitin 2026 dhe garanton:

- Stabilitet në financimin e kostove të personelit;
- Zbatimin e politikave kombëtare të pagave në sektorët e transferuar.

Në total, transfertat e pakushtëzuar (përfshirë edhe komponentin e pagave) paraqitet në rritje të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës.

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme për bashkinë Berat për periudhën 2027-2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	833.737"	872.849"	876.637"	938.763"
1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	520,520	559,632	594,494	625,546
2	Rritja e nivelit të pagave	90,995	90,995	90,995	90,995



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

2. Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale përbën një burim të rëndësishëm financimi për funksionet e transferuara tek bashkitë që prej vitit 2016.

Kjo transfertë mbështet financimin e:

- Arsimit parashkollor dhe personelit mbështetës në arsimin parauniversitar;
- Shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH);
- Administrimit të pyjeve;
- Mirëmbajtjes së rrugëve rurale;
- Ujitjes dhe kullimit;
- Qendrave të shërbimeve sociale (Qendra “Lira”);
- Konvikteve të arsimit parauniversitar.

Parashikimi i shpenzimeve për këto funksione (paga, sigurime, shpenzime operative dhe investime) bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ndërkohë që bashkia ka të drejtë të shtojë fonde nga burimet e veta për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Për Bashkinë Berat, kjo transfertë paraqitet si më poshtë:

- **2027:** 409,342 mijë lekë
- **2028:** 409,342 mijë lekë
- **2029:** 413,436 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2026, kjo transfertë:

- Rritet me rreth **2% në vitet 2027–2028;**
- Rritet me rreth **3% në vitin 2029.**

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkinë Berat për periudhën 2027-2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	623,538 "	62 ; 564 "	62 ; 564 "	635,658 "
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	31,137	31,760	31,760	32,078
2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimit	172,156	175,599	175,599	177,355
3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	65,315	66,621	66,621	67,287
4	Arsimi parauniversitar	21,216	21,640	21,640	21,856
5	Mbrojtja nga zjarri	50,978	51,998	51,998	52,518
6	Mbrojtja sociale	26,994	27,534	27,534	27,809
7	Administrimi i pyjeve	8,337	8,504	8,504	8,589
8	Rrugët	6,362	6,489	6,489	6,554
9	Ujitja dhe Kullimi	18,820	19,197	19,197	19,389



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

3. Transferta e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar parashikohet për financimin e funksioneve të deleguara nga qeveria qendrore.

Kjo transfertë:

- Përdoret për aktivitete të përcaktuara specifiku;
- Bazohet në nevojat konkrete dhe në shpenzime sipas artikujve buxhetorë;
- Planifikohet dhe zbatohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në këtë fazë të përgatitjes së tavanëve, kjo transfertë nuk përfshihet në mënyrë të detajuar, pasi përcaktimi i saj lidhet me programimin specifik të funksioneve të deleguara.

4. Të ardhurat nga burimet e veta

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë një komponent të rëndësishëm të autonomisë financiare të Bashkisë Berat.

Për periudhën 2027–2029 ato parashikohen si më poshtë:

- **2027:** 651,975 mijë lekë
(+5,492 mijë lekë ose +0.8% krahasuar me vitin 2026)
- **2028:** 656,748 mijë lekë
(+4,773 mijë lekë ose +0.7%)
- **2029:** 664,425 mijë lekë
(+7,677 mijë lekë ose +1.2%)

Këto të ardhura përbëhen nga:

a) Taksat dhe tarifat vendore

Ky zë përbën pjesën më të madhe të të ardhurave të veta dhe paraqet stabilitet gjatë gjithë periudhës, duke reflektuar:

- Politika fiskale të pandryshuara;
- Fokus në përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit;
- Kontroll më të mirë të informalitetit.

b) Taksat e ndara

Të ardhurat nga taksat e ndara paraqesin rritje progresive dhe lidhen me:

- Ecurinë e të ardhurave në nivel kombëtar;
- Mekanizmat e shpërndarjes nga qeveria qendrore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Parashikimi i të ardhurave nga burimet e veta për bashkinë Berat për periudhën 2027-2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

Lloji i të Ardhurave		2026	2027	2028	2029
		Plani	Plani	Plani	Plani
	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483	651,975	656,748	664,425
1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809	581,585	581,968	585,182
2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674	70,390	74,780	79,243

Përfundime

- Të ardhurat totale parashikohen me rritje të qëndrueshme gjatë periudhës 2027–2029;
- Transferrat nga buxheti qendror mbeten burimi kryesor i financimit; duke garantuar stabilitetin e buxhetit vendor;
- Të ardhurat nga burimet e veta janë të qëndrueshme, me potencial për përmirësim përmes forcimit të administrimit fiskal;
- Grantet e huaja mbeten një burim plotësues dhe i pasigurt.
- Struktura e të ardhurave është e balancuar dhe mbështet planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Parashikimi i të ardhurave nga burimet e veta për bashkinë Berat për periudhën 2027-2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

Lloji i të Ardhurave		2026	2027	2028	2029
		Plani	Plani	Plani	Plani
	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483	651,975	656,748	664,425
1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809	581,585	581,968	585,182
2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674	70,390	74,780	79,243

Të ardhurat Vendore (taksa&tarifa vendore)

vlerat paraqiten në: 000 ALL

Nr	Emertimi/Muaji	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel				
II	Taksa mbi te ardhurat personale	18,000	23,000	26,000	29,000
III	Taksat vendore	232,794	237,251	241,464	245,836
1	Takse tablele	1,986	1,986	1,986	1,986



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

•	Tabelë për qëllime identifikimi	1,584	1,584	1,584	1,584
•	Tabelë për qëllime reklamimi	402	402	402	402
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	15,776	15,776	15,776	15,776
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	84,342	86,872	89,478	92,162
4	Takse fjetje ne hotel	7,216	7,432	7,655	7,885
5	Takse mbi token bujqesore	18,433	18,433	18,433	18,433
6	Takse e mjeteve te perdorura	42,183	43,794	45,076	46,428
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë pronësisë	3,311	3,410	3,513	3,618
8	Takse mbi ndertesat	51,460	51,460	51,460	51,460
9	Takse Trualli	8,087	8,087	8,087	8,087
10	Te tjera taksa lokale	-	-	-	-
IV	Tarifat vendore	224,028	224,462	224,909	225,370
1	Tarife e pastrimit	107,434	107,434	107,434	107,434
2	Tarife e ndriçimit publik	48,606	48,606	48,606	48,606
3	Tarife gjelberimi publik	41,799	41,799	41,799	41,799
4	Tarife Arsimit	11,723	11,723	11,723	11,723
5	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	-	-	-	-
6	Tarifa urbanistike	732	754	777	800
7	Tarifa te sherbimit administrativ	-	-	-	-
8	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	2,340	2,410	2,483	2,557
9	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	30	31	32	33
10	Tarifa te sherbimit te varrimit	6,380	6,571	6,769	6,972
11	Tarife per lende drusore	80	82	85	87
12	Tarife Ujitje	1,534	1,580	1,627	1,676
13	Tarife ambienti	1,226	1,263	1,301	1,340
14	Tarife therje	-	-	-	-
15	Te tjera tarifa	-	-	-	-
16	Taksa e rentës minerare	180	185	191	197
17	Tarife Urbanistike (kablloret)	1,964	2,023	2,084	2,146
V	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	23,350	24,051	24,772	25,515
1	Te ardhurat per regjistrim	965	994	1,024	1,054
2	Te ardhura nga konviktet	2,980	3,069	3,161	3,256
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	19,405	19,987	20,587	21,204
VI	Te ardhura te tjera	148,310	143,210	139,602	138,704
1	Te ardhura nga parkimi	6,394	6,586	6,783	6,987
2	Te ardhura nga biletat parku dua te luaj	420	433	446	459
3	Te ardhura nga qerate	26,710	27,511	28,337	29,187
4	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	-	-	-	-
5	Te tjera te ardhura nga pronesia	65,789	65,789	65,789	65,789
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	5,900	6,077	6,259	6,447
7	Debitore Biznes + Familje	42,447	36,145	31,299	29,125
8	Banesat Sociale + Enti	-	-	-	-
VII	Te ardhura nga MZSH	650	670	690	710
VIII	Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja				
IX	Grante te huaja pa planifikuar				
X	Te ardhura nga shitje mallra (skrap)				
TOTAL		646,481	651,973	656,748	664,424



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

II. Tavanet përgatitore të shpenzimeve sipas programeve

Në zbatim të metodologjisë së re, shpenzimet janë planifikuar sipas programeve buxhetore, të cilat reflektojnë funksionet kryesore të bashkisë.

1. AA102 – Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse

2027: 212,708 mijë lekë

2028: 222,467 mijë lekë

2029: 225,259 mijë lekë

Siguron funksionimin administrativ dhe mbështetjen e të gjitha programeve të tjera.

2. AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile

2027: 598,835 mijë lekë

2028: 617,308 mijë lekë

2029: 644,704 mijë lekë

Përfaqëson prioritetin kryesor të investimeve dhe shërbimeve publike, me peshën më të madhe në buxhet.

3. AC102 – Arsimi dhe Kujdesi Social

2027: 556,845 mijë lekë

2028: 560,403 mijë lekë

2029: 559,020 mijë lekë

Garanton vazhdimësinë e shërbimeve sociale dhe arsimore, me nivel të qëndrueshëm financimi.

4. AD102 – Bujqësia, Pyjet, Ujërat dhe Siguria Ushqimore

2027: 73,872 mijë lekë

2028: 70,779 mijë lekë

2029: 72,528 mijë lekë

Mbështet zhvillimin rural dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

5. AE102 – Siguria dhe Mbrojtja e Territorit

2027: 114,046 mijë lekë

2028: 115,365 mijë lekë

2029: 121,260 mijë lekë

Ky program mbulon funksione thelbësore që lidhen me garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e territorit, përfshirë shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, si dhe masa të tjera parandaluese dhe ndërhyrëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

6. AF102 – Turizmi, Kultura dhe Sportet

2027: 146,528 mijë lekë

2028: 147,908 mijë lekë

2029: 147,631 mijë lekë

Synon rritjen e potencialit turistik dhe zhvillimin kulturor të qytetit.

7. AG102 – Rezerva dhe Kontigjenca

2027: 16,000 mijë lekë

2028: 18,000 mijë lekë

2029: 20,000 mijë lekë

Siguron përballimin e situatave të paparashikuara dhe menaxhimin e riskut financiar.

Në përfundim themi se Tavanet përgatitore janë hartuar në balancë të plotë, duke garantuar qëndrueshmëri fiskale dhe respektim të disiplinës buxhetore.

- Bashkia Berat vijon zbatimin e suksesshëm të metodologjisë së re të PBA-së;
- Tavanet përgatitore reflektojnë prioritetet e qarta zhvillimore;
- Struktura e buxhetit është e qëndrueshme dhe e balancuar;
- Programet buxhetore janë të konsoliduara dhe të menaxhueshme.

Parashikimi i taveve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, që do të shërbejnë për procesin e planifikimit të shpenzimeve, është si më poshtë:

Tavanet e të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027 – 2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

Lloji i të Ardhurave		2026	2027	2028	2029
		Plani	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483	651,975	656,748	664,425
A.1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809	581,585	581,968	585,182
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674	70,390	74,780	79,243
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,012,831	1,059,969	1,094,831	1,129,977
B.1	Transferta e Pakushtëzuar e Pergjithshme	520,520	559,632	594,494	625,546
B.2	Transferta Sektoriale per rritjen e nivelit te pagave	90,995	90,995	90,995	90,995
B.3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	401,316	409,342	409,342	413,436
C	Grante te Huaja	3,506	6,890	651	0
C.1	Grante te Huaja	3,506	6,890	651	0
Total te ardhura/burime buxhetore (A+B+C)		1,662,820	1,718,834	1,752,230	1,794,402



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029

vlerat paraqiten në: 000 ALL

Emërtimi	2026	2027	2028	2029
AA102 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse				
Shpenzime Personeli (600-601)	142,318	144,453	146,620	150,286
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	50,236	66,255	70,847	72,973
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	3,719	2,000	5,000	2,000
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AA102	196,273	212,708	222,467	225,259
AB102 - Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile				
Shpenzime Personeli (600-601)	159,060	161,446	163,868	167,965
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	268,544	272,022	277,462	285,786
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	93,240	165,367	175,978	190,953
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AB102	520,844	598,835	617,308	644,704
AC102 - Arsimi dhe Kujdesi Social				
Shpenzime Personeli (600-601)	434,665	441,185	447,803	458,998
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	83,440	85,460	87,400	90,022
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	94,711	30,200	25,200	12,000
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AC102	612,816	556,845	560,403	561,020
AD102 - Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore				
Shpenzime Personeli (600-601)	48,797	49,773	50,768	52,037
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	15,511	16,011	16,011	16,491
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	3,000	2,500	4,000	4,000
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	2,855	5,588	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AD102	70,163	73,872	70,779	72,528
AE102 - Siguria dhe Mbrojtja e Territorit				
Shpenzime Personeli (600-601)	104,021	105,581	107,165	109,844
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	6,680	7,965	7,200	7,416



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	100	500	1,000	4,000
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AE102	110,801	114,046	115,365	121,260
AF102 - Turizmi, Kultura dhe Sportet				
Shpenzime Personeli (600-601)	67,711	68,726	69,757	71,501
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	68,560	70,000	71,000	73,130
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	1,000	6,500	6,500	5,000
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	651	1,302	651	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AF102	137,922	146,528	147,908	149,631
AG102 - Rezerva & Kontigjenca				
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	14,000	16,000	18,000	20,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0	0
Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme AG102	14,000	16,000	18,000	20,000

Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	956,572	971,164	985,981	1,010,631
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	506,971	533,713	547,920	565,818
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	195,770	207,067	217,678	217,953
Totali i Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	3,506	6,890	651	0
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,662,820	1,718,834	1,752,230	1,794,402

Propozojmë miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e detajuar të PBA 2027–2029 dhe buxhetit të vitit 2027.

Drafti i parë i PBA 2027-2029 do të paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak brenda muajit Qershor 2025.

Ju faleminderit !



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Ervin	CECA	Kryetar i Bashkisë (NA)
Arisa	TOSKA	Sekretar i Përgjithshëm (Koordinator)
Rovena	SHEHU	Drejtor i Financës dhe Buxhetit (Sekretar i GMS)
Etleva	DHIMA	N/Kryetar i Bashkisë
Bledar	ÇILI	N/Kryetar i Bashkisë
Erida	NASUFI	Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (i komanduar)
Marius	QYTYKU	Drejtor i Integritetit Europian dhe Projekteve
Petro	SINJARI	Drejtor i Drejtorisë Juridike
Daniel	BENISHTA	Drejtor i Taksave dhe Tarifave (i komanduar)
Sokol	TOSKA	Drejtor i Shërbimeve, Mbrojtjes civile, Transportit dhe Pronave
Piro	XHEBLATI	Drejtor i Shërbimit Social
Kreshnik	ZAIMI	Drejtor i Policisë Bashkiake
Joana	METAJ	Drejtor i IMT-së
Artan	MERKO	Drejtor i MZSH-së
Klodiana	HOXHA	Drejtor i Nj. Sh. Drejtoria Arsimore
Jonana	MELËNGU	Drejtor i Nj. Sh. Agjencia e Shërbimeve Publike
Bledar	ÇILI	Drejtor i Nj. Sh. Drejtoria e Bujqësisë, administrim pyje, ujëra e shërbim veterinar
Arben	QAFA	Drejtor i Nj. Sh. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”
Alma	KULE	Drejtor i Nj. Sh. Qendra “Lira”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE

Të nderuar Këshilltarw !

Bashkia Berat ka planifikuar në buxhetin e vitit 2026 një fond për subvencionimin e qirasë për familjet me probleme sociale dhe ekonomike, të cilat kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuar, invalidë dhe me të ardhura mujore shumë të ulëta, kryesisht me pension dhe me përkrahje sociale, dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 2, pikat 34, 42, 45 dhe nenin 30 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, si ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018 ” Për strehimin social ”.

Bashkia Berat, duke filluar nga viti 2014, ka shlyer çdo vit këstet e kredisë së marrë nga Banka e Këshillit të Europës (CEB), ku bashkia ka detyrimin për shlyerjen e principalit, ndërsa qeveria mbulon interesat. Deri më sot është shlyer shuma prej 585,107 euro dhe mbetet për t’u shlyer deri në korrik 2026 vlera prej 2,600 euro.

Për fillimin e procedurës së subvencionimit të qirasë, bashkia ka njoftuar të gjitha familjet duke mos përjashtuar asnjë për të sjellë dokumentacionin e plotë të të ardhurave familjare mujore bazë, për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë, bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”.

Komisioni i Strehimit, i mbledhur më datë 17.03.2026, i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga banorët e strehuar nw banesat sociale, arriti në këto përfundime:

Nga 49 familje aplikante, 35 familje përfitojnë subvencionimin e qirasë, pasi plotësojnë kriteret ligjore dhe dokumentacionin e kërkuar. Konkretisht: 11 familje kanë të ardhura vetëm nga pagesa e paafëtisë; 2 familje përfitojnë ndihmë ekonomike; 2 familje janë punëkërkues të papunë; 17 familje kanë të ardhura nga pensioni; 3 familje kanë të ardhura mujore shumë të ulëta.

Në përfundim, kërkojmë miratimin tuaj për listën e përfituesve, e përbërë nga 35 familje të kualifikuara nga Komisioni i Strehimit.

Bashkëlidhur gjendet lista e përfituesve dhe masa e subvencionimit të llogaritur për secilën familje.

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

**PËR MIRATIMIN E SHËRBIMIT E-BUSES, PËRCAKTIMIN E INTERERAREVE,
STACIONEVE DHE ÇMITIT TË BILETËS ,SI SHËRBIM PLOTËSUES I
TRANSPORTIT QYTETAS**

RELACION

Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, një iniciativë e rëndësishme që synon rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e qarkullimit urban.

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore dhe Komisioni European, ndërsa zbatohet në bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Berat dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ai përfaqëson një hap konkret drejt modernizimit të infrastrukturës dhe adoptimit të praktikave bashkëkohore në menaxhimin e trafikut dhe mobilitetit urban.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, është ngritur një grup pune pranë Bashkisë Berat, i cili ka hartuar organizimin e shërbimit, përcaktimin e itinerarëve, frekuencave dhe modaliteteve të funksionimit të transportit, në përputhje me nevojat e qytetit dhe flukset turistike.

Në kuadër të këtij projekti, Bashkia Berat ka përfituar tre (3) autobusë elektrikë, të shoqëruar me tre (3) stacione karikimi. Këto mjete do të përdoren për të lehtësuar lëvizjen e vizitorëve drejt zonave me interes historik dhe kulturor, veçanërisht në zonën e Kalasë dhe pjesë të tjera të rëndësishme të qytetit.

Investimi kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e ndotjes së mjedisit, përmirësimin e efikasitetit të transportit publik dhe rritjen e cilësisë së përvojës turistike. Në të njëjtën kohë, ai përforcon angazhimin e Bashkisë Berat për zhvillim të qëndrueshëm, promovimin e transportit të gjelbër dhe krijimin e një qyteti më të aksesueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

Përshkrimi i Itinerarit 1: Qendër – Kala dhe anasjelltas

Itinerari i parë parashikon lidhjen direkte midis Qendrës dhe zonës së Kalasë, në të dy drejtimet,

pa ndalesa të ndërmjetme. Ky konfigurim synon të ofrojë një lëvizje të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikase për qytetarët dhe vizitorët.

Shërbimi do të operojë sipas një grafiku sezonal:

Gjatë muajve janar, shkurt, mars, nëntor dhe dhjetor, autobusët do të qarkullojnë çdo 60 minuta, nga ora 08:00 deri në orën 19:00.

Gjatë muajve prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe tetor, frekuenca e lëvizjes do të rritet në çdo 30 minuta, me orar funksionimi nga ora 07:00 deri në orën 20:00, duke reflektuar rritjen e kërkesës gjatë sezonit më aktiv.

Kapaciteti i çdo autobusi është 18 pasagjerë, duke garantuar një shërbim të përshtatshëm dhe komod.

Për operimin e këtij itinerari do të angazhohen dy autobusë: një në drejtimin vajtje dhe një në drejtimin kthim, duke siguruar funksionim të vazhdueshëm dhe respektim të frekuencës së planifikuar.

Përshkrimi i Itinerarit 2: Terminal – Kala dhe anasjelltas

Itinerari i dytë parashikon lidhjen direkte ndërmjet Terminalit dhe zonës së Kalasë, në të dy drejtimet, pa ndalesa të ndërmjetme. Ky itinerar është konceptuar për të ofruar një shërbim të drejtpërdrejtë dhe efikas, duke lehtësuar aksesin e vizitorëve dhe qytetarëve drejt zonës historike.

Shërbimi do të operojë sipas një grafiku sezonal:

Gjatë muajve janar, shkurt, mars, nëntor dhe dhjetor, autobusët do të qarkullojnë çdo 60 minuta, nga ora 08:00 deri në orën 19:00.

Gjatë muajve të tjerë të vitit, frekuenca do të mbetet çdo 60 minuta, por me orar të zgjatur funksionimi nga ora 08:00 deri në orën 20:00.

Kapaciteti i çdo autobusi është 18 pasagjerë, duke garantuar një shërbim komod dhe të përshtatshëm për përdoruesit. Për operimin e këtij itinerari do të angazhohet një autobus.

Çmimi i biletës së propozuar është prej 100 lekësh për udhëtim e përcaktuar në një nivel të përballueshëm për turistët, me qëllim nxitjen e përdorimit të transportit publik dhe reduktimin e qarkullimit të mjeteve private në zonat me rëndësi historike dhe turistike.

Nr	Pershkrimi i shpenzimeve	Vlera per 12 muaj	Vlera per 9 muaj
1	Shpenzime page	10,688,700	8,016,525
2	Shpenzime sigurime shoqerore e shendetesore	1,785,013	1,338,760
3	Shpenzime operative dhe te mirembajtjes	8,803,924	6,602,943
4	Investimet	700,000	525,000
	Totali I shpenzimeve pa tvsh	21,277,637	15,958,228
	TVSH ne shitje	4,255,527	3,191,646
			-
	Totali me tvsh	25,533,164	19,149,873
Nr	Pershkrimi i te adhurave	Vlera per 12 muaj	Vlera per 9 muaj
1	Te ardhura nga biletat me tvsh	25,536,600	19,152,450

Shpenzimet do të mbulohen 100 % nga të ardhurat e siguruara nga shitja e biletave për shërbimin e transportit.

Shërbimi E-Buses do të jetë pjesë e shoqërisë Berat City Green me akisioner Bashkinë Berat 100% të aksioneve.

Duke marrë në konsideratë përfitimet e drejtpërdrejta për qytetarët dhe vizitorët, ju ftojmë të shqyrtoni dhe të jepni miratimin tuaj për këtë iniciativë, e cila përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të transportit qytetas në Bashkinë Berat.

Grupi i punës:

1. Etleva Dhima (Zv.Kryetar i Bashkisë)
2. Bledar Çili (Zv.Kryetar i Bashkisë)
3. Arisa Toska (Sekretar i Përgjithshëm)
4. Petro Sinjari (Drejt看 Juridik)
5. Sokol Toska (Drejt看 i Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Mjedisit)
6. Rovena Shehu (Drejt看 e Financës dhe Buxhetit)
7. Marius Qytyku (Drejt看 i Integritimit Evropian dhe Projekteve)
8. Daniel Benishta (Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave)
9. Joana Melëngu (Drejt看 i Agjencisë së Shërbimeve Publike)
10. Kamberije Selimi (Përgjegjës Sektorit të Financës, ASHP)

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më ____ . ____ .2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT SI KAPITAL TË MJETEVE DHE PAISJEVE TË PROJEKTIT
“PAISJE PËR MBËSHTETJEN E SHËRBIMEVE BASHKIAKE PËR PËRMIRËSIMIN E
MENAXHIMIT TË TRAFIKUT” NË FAVOR TË SHOQERISË BERAT CITY GREEN -BCG SH.A

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”. Ky projekt financohet nga Banka Botërore dhe Komisioni European dhe zbatohet nga Bashkia Berat dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit . Në kuadër të këtij projekti, Bashkia është përfituese e tre (3) autobusave elektrik bashkë me tre (3) karikues si dhe 2(dy) Buggy elektrike.

Projekti ka dhuruar për Bashkinë Berat 3(tre) autobusa elektrikë bashkë me karikuesat , 2(dy) buggy elektrike(makina 8 vendëshe të hapura) dhe 1(një) karikues të shpejtë të cilët do të shërbejnë për nevojat e Bashkisë Berat . Të dhënta e mjeteve dhe paisjeve janë si më poshtë.

a. Autobus Elektrik marka KingLong dhe karikues elektrik EV tip 2. Numri i shasisë së mjetit: LA9LC10D3SALA6995, Nr serial i mjetit 0000000836469 , Targa e mjetit : AB 826 UG Vlera e mjetit : **18,707,099.88 Lekë me Tvsh**

b. Autobus Elektrik marka KingLong dhe karikues elektrik EV tip 2. Numri i shasisë së mjetit: LA9LC10D1SALA6994, Nr serial i mjetit 0000000836474 , Targa e mjetit : AB 833 UG Vlera e mjetit : **18,707,099.88 Lekë me Tvsh**

c. b. Autobus Elektrik marka KingLong dhe karikues elektrik EV tip 2. Numri i shasisë së mjetit: LA9LC10DXSALA6993, Nr serial i mjetit 0000000836471 , Targa e mjetit : AB 836 UG Vlera e mjetit : **18,707,099.88 Lekë me Tvsh**

d.Buggy elektrik 8 vendësh marka LEXSONG.Nr i shasisë LGS2A41YAR1500026 me vlerë **1,718,500.78 Lekë me Tvsh**

e. Buggy elektrik 8 vendësh marka LEXSONG.Nr i shasisë LGS2A41YAR1500027 me vlerë **1,718,500.78 Lekë me Tvsh**

f. Karikues DC i shpejtë 60 kë me vlere **1,031,100 Lekë me Tvsh**

Këto mjete nevojiten të transferohen në pronësi të Shoqërisë Berat City Green - BCG SH.A e cila është edhe ndërmarrja përkatëse që do të merret me administriminë transportit turistik . Nevojitet miratimi juaj për transferimin si kapital i mjeteve të cituara më sipër në favor të Shoqërisë Berat City Green SH.A

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË
Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. SOKRAT VRUSHAJ.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ . ____ .2026, bazuar në kërkesën e z. Sokrat Vrushaj me nr.7424 prot, datë 29.12.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.101, datë 22.12.2025 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Familja Vrushaj, përbëhet nga dy anëtarë dhe jetojnë në lagjen “Donika Kastrioti”, Berat, në një apartament të të afërmeve, banesë me kushte modeste jetese. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror i Rajonit 3 pasi administruan kërkesën e z.Sokrat Vrushaj kryefamiljar, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.

Familja prej vitesh trajtohet me dy pensione minimale, me pagesa kredie dhe rezulton se gjendja e tyre ekonomike është e vështirë.



Burimet e të ardhurave janë të kufizuara, të pamjaftueshme për të përballur nevojat bazë të familjes si ushqim, veshmbathje, energjia elektrike dhe shpenzime të tjera.

Gjithashtu, familja është përballur me një fatkeqësi ku djali i tyre i vetëm, i ri, ka ndërruar jetë në një aksident dhe tashmë janë pa asnjë mbështetje.

Bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë vlerësimit social-ekonomike dhe verifikimet e dokumentacionit përkatës, familja ndodhet në kushte të vështira social ekonomike, pas analizës së të ardhurat janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë jetike, duke e vendosur familjen në situatë vështirësie ekonomike.

Të ndodhur në këto kushte dhe vështirësi, duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga z.Sokrat Vrushaj, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat ekonomike nga strukturat e shërbimit social, kushtet ku jeton familja, propozojmë që z.Sokrat Vrushaj të mbështetet në masën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë .

Bashkëngjitur gjeni:

1. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
2. Certifikatë vdekje për të ndjetin Endrit Vrushaj.
3. Vërtetim masa e pensionit znj.Gjylzemine Vrushaj.
4. Vërtetim masa e pensionit z.Sokrat Vrushaj.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati